



VENDIM

Nr.138 Datë 07.12.2011

PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË KESH SH.A PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR PERIUDHËN E
TRETË RREGULLATORE 2012 – 2014

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga te Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin Planit të Investimeve të KESH sha për periudhën e tretë rregullatore,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë KESH sh.a për Planin e Investimeve për periudhën e tretë rregullatore në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga te Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi:

1. Të miratojë aplikimin e KESH sh.a për miratimin e Planit të Investimeve për periudhën e tretë rregullatore.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI